



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 91, datë 13.06.2018

PËR
MIRATIMIN E UDHËZIMIT “MBI MËNYRËN E TREGTIMIT, KLERIMIT DHE
SHLYERJES SË TRANSAKSIONEVE” DHE LISTËN E NDRYSHUAR TË
KOMISIONEVE DHE TARIFAVE TË SHOQËRISË “BURSA SHQIPTARE E TITUJVE
(ALSE)” SH.A.

Në bazë të nenit 14, pika 22 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 81, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, nenit 17, shkronja “b”, “c” e Rregullores nr. 120, datë 02.10.2008 “Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve”, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Udhëzimit “Mbi mënyrën e tregtimit, klerimit dhe shlyerjes së transaksioneve”, të ndryshuar si më poshtë:

Neni 5.2, paragrafi 2 ndryshon si më poshtë:

Vlera minimale e transaksionit në bllok është 15,000,000 ALL.

Kudo gjatë udhëzimit, shifra 20,000,000 ALL bëhet 15,000,000 ALL.

Neni 6, paragrafi 3 ndryshon si më poshtë:

Rregullorja e Bursës Shqiptare të Titujve parashikon dy lloj kufizime çmimesh:

- *Kufijtë dinamik ($\pm 3\%$ i çmimit të referencës për bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare dhe $\pm 10\%$ për titujt e tjerë)*
- *Kufijtë statikë ($\pm 10\%$ i çmimit të fundit mesatar zyrtar i një dite më parë të tregtimit për bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare dhe $\pm 30\%$ për titujt e tjerë).*

2. Miratimin e listës së ndryshuar të komisioneve dhe tarifave të shoqërisë “Bursa Shqiptare e Titujve (ALSE)” sh.a.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI